



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



RAPORTI RREGULLATIV
Përcaktimi i të Hyrave Maksimale të Lejuara për Ngrohtoren e Qytetit Termokos SH.A.
Sezoni i Ngrohjes 2019/2020

Prishtinë, tetor 2019



PËRMBAJTJA

Faqe

1	Hyrje.....	3
2	Parimet dhe Formulimi i Metodologjisë Tarifore	4
3	Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara.....	6
3.1	Vlerësimi dhe përcaktimi i kostove operative të lejuara	7
3.2	Përcaktimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB).....	14
3.2.1	Përcaktimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve Fillestarë (RABnfill.).....	14
3.2.2	Përcaktimi i Investimeve të reja të lejuara	14
3.2.3	Përcaktimi i Kapitalit Punues	17
3.2.4	Zhvlerësimi Vjetorë i Aseteve - realizuar në sezonin 2018/19 ('n-1')	17
3.2.5	Tjetërsimet.....	17
3.3	Vlerësimi dhe Përcaktimi i Zhvlerësimit Vjetor për sezonin 2019/2020.....	18
3.4	Përcaktimi i Kthimit të Lejuar në RAB (Fitimi i Lejuar)	19
3.5	Përcaktimi i Kostos së Humbjeve në Rrjet.....	23
3.6	Përshtatja (Akhustimi).....	23
3.7	Llogaritja e të Hyrave të Lejuara - Përmbledhje.....	23
4	Bilanci i Energjisë Termike	24

Figurat

Figura 1: Skema e llogaritjes së të hyrave të lejuara.....	5
Figura 2: Paraqitja skematike e kostove operacionale të propozuara nga NQ Termokos dhe të lejuara nga ZRRE-ja për sezonin e ngrohjes 2019/2020.....	8
Figura 3: Paraqitje grafike e Bilancit të energjisë termike për NQ Termokos –sezonin 2019/2020	25

Tabelat

Tabela 1: Kostot e paraqitura nga ana e NQ Termokos SH.A., dhe ato të lejuara nga ZRRE (Në €).....	8
Tabela 2: RAB dhe komponentët e tij - NQ TERMOKOS sezoni i ngrohjes 2019/2020	18
Tabela 3: RABf dhe komponentët e tij - NQ TERMOKOS sezoni i ngrohjes 2019/2020	18
Tabela 4: Kategorizimi i Aseteve (RAB) dhe norma mesatare e ponderuar e zhvlerësimit	19
Tabela 5: Kthimi i Lejuar (Profiti i Lejuar) në RABf për sezonin e ngrohjes 2019/2020	22
Tabela 6: Të Hyrat e lejuara për NQ Termokos sezoni i ngrohjes 2019/2020	24
Tabela 7: Përmbledhje e Bilancit të energjisë termike	24



1 Hyrje

Në pajtim me legjislacionin primar – nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është përgjegjëse për përcaktimin e metodologjisë së tarifave dhe aprovimin e tarifave në sektorin e rregulluar të energjisë; këtu janë një sërë parimesh të gjera, siç janë parimet e mos-diskriminimit dhe arsyeshmërisë me të cilat ndërmarrjet e energjisë do të mund t'i rikthenin të gjitha kostot e arsyeshme përfshirë edhe kthimin e arsyeshëm në investimet e tyre. Gjithashtu nenet 18 dhe 19 të Ligjit për Energjinë Termike përcaktojnë se Furnizuesi me obligimin e shërbimit publik, kryen furnizimin me energji termike me tarifa të rregulluara.

Përderisa sektori i energjisë termike në transportimin dhe shpërndarjen e energjisë termike klasifikohet si monopol i natyrshëm, dhe për arsye se gjithashtu në gjenerim dhe furnizim ende nuk ekziston konkurrenca, atëherë tarifat e ngrohjes qendrore, që i përmbajnë të gjitha komponentët e lartpërmendura, i nënshtrohen përcaktimit - miratimit nga ZRRE-ja.

Brenda kompetencave dhe obligimeve të veta ligjore, Zyra e Rregullatorit për Energji ka nxjerrë Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike. Rregulla përcakton procedurat për dorëzimin, shqyrtimin e aplikacionit tarifor dhe aprovimin e tarifave, si dhe Metodologjinë për llogaritjen e të hyrave të lejuara dhe tarifave.

Për përcaktimin e të hyrave të lejuara për sezonin e ngrohjes 2019/2020 janë marrë parasysh si vijon:

- Informatat e dhëna nga NQ Termokosi në aplikacionin e tyre tarifor për sezonin e ngrohjes 2019/2020;
- Informatat e dhëna nga NQ Termokosi gjatë raportimit rregullativ të realizimeve – shpenzimet dhe të ardhurat, asetet / investimet, si dhe informatat teknike dhe për konsumatorë që aktualisht janë realizuar në sezonin e ngrohjes 2018/2019 dhe në sezonet e mëparshme;

Ecuria e procesit të shqyrtimit tarifor:

- **Me 02 korrik 2019** – ZRRE ka lëshuar shkresën për njoftimin e fillimit të shqyrtimit të tarifave për NQ Termokos për sezonin 2019/2020;
- **Me 5 korrik 2019** – ZRRE përmes e-mailit i ka dërguar NQ Termokos kërkesën për të dhëna dhe informata, ku janë përshkruar detajisht të dhënat dhe informatat që NQ Termokos duhet dorëzuar për shqyrtimin tarifor, si dhe Planin dhe Orarin;
- **Me 22 korrik 2019** – NQ Termokos përmes e-mailit ka dorëzuar aplikacionin tarifor të pjesshëm me disa nga të dhënat dhe informatat e kërkuara për shqyrtim tarifor;
- **Me 30 korrik 2019** - Takim mes ZRRE-NQ Termokos ku u diskutua lidhur me shqyrtimin e tarifave për sezonin 2019/20, paraqitjen e projekteve investive dhe analizave financiare përkatëse dhe kostove tjera operative për kompletim të aplikacionit tarifor;
- **Me 9 gusht 2019** – NQ Termokos ka dorëzuar të dhëna, informata dhe dokumentacion shtesë në kuadër të aplikacionit tarifor për sezonin 2019/2020;
- **Me 23 gusht 2019** – Pas analizimit dhe vlerësimit të të dhënave dhe informatave të dorëzuara nga NQ Termokos, ZRRE ka dërguar komentet me shkrim, ku janë specifikuar kërkesat për korrigjim, përmirësim dhe plotësim të aplikacionit fillestarë;
- **Me 05 shtator 2019** – NQ Termokos ka ri-dorëzuar aplikacionin me disa nga korrigjimet, përmirësimet dhe plotësimet e kërkuara në komentet e ZRRE-së, si dhe përgjigjet në komentet e ZRRE-së.



2 Parimet dhe Formulimi i Metodologjisë Tarifore

Për përcaktimin e të Hyrave të lejuara dhe të tarifave të energjisë termike për sezonin 2019/2020 është zbatuar Metodologjia e përcaktuar në Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike.

Parimet

Parim bazë i kësaj metodologjie është se tarifat për ndërmarrjet që ofrojnë shërbime publike duhet të mbulojnë të gjitha kostot - operative dhe kapitale, kështu që në njërin anë konsumatorët nuk do të duhej të paguajnë më tepër se sa kostoja e shkaktuar për ofrimin e shërbimeve, ndërsa në anën tjetër ndërmarrja e shërbimeve publike duhet të mbulojë të gjitha kostot e arsyetuara plus një normë të arsyeshme të kthimit në investimet kapitale. Çmimi final i shërbimit zakonisht përcaktohet për të përfshirë të gjitha kostot operative të ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime publike, d.m.th., të mbulojë koston e prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit (operimi dhe mirëmbajtja, lënda djegëse, pagat, kostot e humbjeve në rrejt, shpenzimet e përbashkëta dhe administrative, etj.) plus një kthim të arsyeshëm në investimet që janë dedikuar ofrimit të shërbimit publik.

Duke qenë se në disa raste rregullimi i tillë nuk nxit ndërmarrjet për të ngritur efikasitetin operativ dhe të stimuloj kursimin e shpenzimeve, përkundrazi mund të nxisin mbi-investime në asete dhe gjithashtu, dhe duke marrë parasysh obligimin e Rregullatorit për të mbrojtur konsumatorët, kërkohet që ndërmarrjet jo vetëm të dëshmojnë “shpenzimet e arsyeshme” të deklaruara, por edhe të tregojnë një rritje të efikasitetit operativ dhe të kostove. Masat e tilla krijojnë bazë për bashkërendimin në fillim të shqyrtimit tarifor, në të cilën Rregullatori shpërblen apo ndëshkon ndërmarrjen për rritjen apo rënien e efikasitetit dhe kontrollit të kostos.

Formulimi

Me qëllim të llogaritjes së të Hyrave të lejuara dhe llogaritjes përfundimtare të tarifave, në Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike (shtojcat 1,2,3, dhe 6) është dhënë në detaje formulimi i Metodologjisë tarifore. Megjithatë, për arsye konsistence, formulimi do të paraqitet shkurtimisht edhe në këtë raport.

Skematikisht, Metodologjia tarifore mund të tregohet si më poshtë. Kostot të cilat ndërmarrja duhet t'i mbulojë përbëhen nga kostot operative, nga zhvlerësimi që paraqet mundësinë që ndërmarrja të zëvendësoj asetet e veta, koston e humbjeve të rrejtit dhe kthimin në Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB), e cila në fakt paraqet fitimin për ndërmarrjen.



$$RAB_n^{p\text{ërf.}} = RAB_n^{\text{fill.}} + INV_n + WC_n - DEP_{n-1} - DIS_{n-1}$$

Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB) paraqet asetet e ndërmarrjes të konsideruara për përdorim dhe të dobishme për ofrimin e shërbimit publik, e të cilat përfshijnë: i) Bazën e Rregulluar të Aseteve fillestar ($RAB_n^{\text{fill.}}$) që faktikisht paraqet RAB-in përfundimtarë të realizuar në sezonin paraprak 2017/18 (n-1); ii) investimet e reja kur janë të planifikuara dhe të aprovuara nga Rregullatori (INV_n); iii) kapitali i mjaftueshëm punues për kompaninë që të kryejë aktivitetet e saj (WC_n); Zhvlerësimin e asetëve të realizuar në sezonin paraprak 2017/18 (n-1) (DEP_{n-1}) dhe iv) Asetet e tjetërsuara (DIS_{n-1}).

ZRRE-ja, si Normë të Kthimit, ka marrë vlerën e WACC-ut (Mesatares së ponderuar të kostos së kapitalit). WACC (%) është shuma e mesatares së ponderuar të kostos së ekuitetit dhe kostos së borxhit, dhe është llogaritur sipas formulës:

$$WACC = [(D/V) * k_d] + [(E/V) * k_e]$$

Ku:

D/V -	Pjesa e borxhit nga baza totale e kapitalit
E/V -	Pjesa e ekuitetit nga baza totale e kapitalit
V -	Baza totale e kapitalit, e cila është i gjithë ekuiteti dhe borxhi
k_d -	Kostoja e borxhit
k_e -	Kostoja e Ekuitetit

3 Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara

Për përcaktimin e të Hyrave të lejuara të NQ Termokos SH.A. për sezonin 2019/2020, në pajtim Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, ZRRE ka ndërmarrë si vijon:

- 1) Vlerësimin dhe përcaktimin e kostove operative të lejuara;
- 2) Vlerësimin dhe përcaktimin e zhvlerësimit;
- 3) Përcaktimin e Kthimit të lejuar në RAB (kthimit në investime), i cili përfshin:
 - a) përcaktimin e RAB-it – vlerësimi dhe aprovimi i asetëve të kompanisë, verifikimi dhe aprovimi i investimeve të planifikuara dhe kapitali punues; dhe
 - b) llogaritjen e Normës së kthimit të lejuar (RoR)/ WACC;
- 4) Vlerësimin dhe përcaktimin e kostos së lejuar për humbjet në rrjet.

Në përcaktimin e të Hyrave të lejuara, ZRRE ka marrë parasysh sa vijon:

- Informatat e ofruara nga NQ Termokosi në aplikacionin e tij për tarifën për sezonin e ngrohjes 2019/2020 – informatën rreth të ardhurave të parashikuara nga shitja e ngrohjes dhe nga shërbimet e tjera të ndërlidhura, kostot e parashikuara totale, asetet dhe investimet e planifikuara, prodhimin dhe furnizimin e parashikuar të ngrohjes, si dhe sipërfaqen ngrohëse të parashikuar;
- Informatat e ofruara nga NQ Termokosi gjatë raportimit rregullativ – shpenzimet dhe të ardhurat, asetet/ investimet, si edhe informatat teknike dhe për konsumatorë të cilat faktikisht janë realizuar në sezonin e kaluar 2018/2019;
- Informatat që ZRRE i ka siguruar nga shqyrtimet tarifore dhe monitorimet e realizimeve dhe performancës të sezoneve / viteve të kaluara.



Duke e ditur se informatat e parashikuara janë thelbësore për përcaktimin e të Hyrave të lejuara, këto do të duhej të ishin të besueshme dhe reale. Përgjithësisht, në parashikimin / planifikimin e biznesit do të duhej të kemi qasje reale të përcjellur me vlerësim të hollësishëm të faktorëve të shumtë që ndikojnë në biznes; p.sh., vlerësimi i tregut dhe parashikimi i zgjerimit të bazës së konsumatorëve, vlerësimi i prodhimit / mundësitë e furnizimit dhe mundësitë financiare të kompanisë. Natyrisht, parashikimi/planifikimi i drejtë duhet të bazohet në të dhënat që kompania i ka realizuar në të kaluarën gjatë një periudhe të caktuar.

Duhet cekur këtu se, aplikacioni për tarifa i NQ Termokos ka qenë mjaft i detajuar dhe i kompletuar. Megjithatë, në disa nga të dhënat dhe informatat që ka përmbajtur aplikacioni janë vërejtur pasaktësi, mos-përputhje dhe jo-konsistencë, të cilat janë përmirësuar sqaruar dhe plotësuar pas komenteve të ZRRE-së dhe takimeve të përbashkëta ZRRE-NQ Termokos.

Në fakt, sa i përket informatave të parashikuara (siç është përcaktuar në Shtojcën 4 të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, NQ Termokosi i ka dorëzuar ZRRE-së pasqyrat/tabelat që përshijnë të ardhurat dhe kostot e parashikuara, të dhëna teknike dhe të konsumatorëve, asetet operative dhe investimet e parashikuara, për periudhën një vjeçare që mbulon plotësisht sezonin e ngrohjes – periudha: 15 tetor 2019 – 14 tetor 2020. Ndërsa si dokumente mbështetëse ka dorëzuar: i) Raportin e auditorit dhe Pasqyrat financiare statusore për vitin 2018; ii) Matjet e konsumit të regjistruara në sezonin e kaluar sipas Listës së nënstacioneve - të dhënat për sipërfaqet ngrohëse dhe kapacitetet përkatëse, si dhe të dhënat tjera teknike; iii) Listën e asetëve – të dhënat detale për asetet fikse ku janë dhënë vlera fillestare (e blerjes), zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e tanishme e asetëve (e dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale); iv) Planifikimet e Investimeve në periudhë njëvjeçare që përfshinë sezonin 2019/20; v) Planifikimet për faturimin e konsumatorëve bazuar në furnizimin / konsumin e matur; vi) Matjet e regjistruara për energjinë termike të prodhuar nga kogjenerimi (dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale; dhe vii) Të dhëna të parashikuara për faturimin e konsumatorëve 2019/2020 bazuar në realizimet në matjen e konsumit dhe në sipërfaqen ngrohëse të konsumatorëve në sezonin e kaluar 2018/2019.

ZRRE-ja ka bërë përpjekje dhe ka angazhuar ekspertizën në dispozicion për të bërë një vlerësim sa më real të informatave të parashikuara të dorëzuara nga ana e Termokosit. Është bërë një analizë gjithëpërfshirëse dhe vlerësim i informatave të paraqitura, që është përcjellur me krahasimin e të dhënave respektive nga sezonet e kaluara, me qëllim që të bëhet përcaktimi (parashikimi) i saktë i të hyrave të lejuara për sezonin 2019/2020.

3.1 Vlerësimi dhe përcaktimi i kostove operative të lejuara

Planifikimet për kostot operative të dorëzuara nga ana e NQ Termokosi për periudhën 15 tetor 2019 – 14 tetor 2020, periudhë kjo që mbulon gjithë sezonin e ngrohjes 2019/2020, janë strukturuar si kosto variabël dhe fikse, e cila ndarje kryesisht është në pajtim me dispozitat e Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, si dhe me parimet e avancuara të kontabilitetit dhe me Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

Në këtë seksion do të tregohen në mënyrë tabelare shpenzimet e parashikuara siç janë prezantuar nga NQ Termokosi dhe shpenzimet operative të lejuara që ZRRE i ka aprovuar (Tabela 1.) Në vijim të tabelës është dhënë shpjegimi analitik për secilin pozicion të kostove operative.



Tabela 1: Kostot e paraqitura nga ana e NQ Termokos SH.A., dhe ato të lejuara nga ZRRE (Në €)

Kostot Operative Sezoni 2019/2020		Propozuar nga NQ Termokos	Lejuar nga ZRRE
Kostot Variabile			
1	Gjenerimi vetanak	319,500	319,500
2	Blerjet e energjise nga Kogjenerimi-komp. Variabile	374,360	374,360
3	Kemikaljet për trajtimin e ujit	40,000	35,000
4	Uji	95,000	95,000
5	Energjia elektrike (prodh. & Nënst. Distr.)	549,199	549,199
6	Kost. e personelit (puna direkte)	870,034	841,454
7	Taksa vjetore e licencave	0	1,364
8	Borxhi i keq i lejuar	0	314,440
9	Total kost. variabile	2,248,093	2,530,317
Kostot fikse			
10	Materialet, shërbimet	110,200	86,500
11	Riparimet e mirëmbajtja	210,800	85,000
12	Blerjet e energjisë nga Kogjenerimi - komp.Fikse	815,024	815,024
13	Shpenzimet për administratë	115,900	82,000
14	Shpenzimet e personelit (te ndryshme nga puna direkte)	920,851	749,608
15	Kostot e shites dhe tjera administrative	938,809	182,415
16	Total kostot fikse	3,111,584	2,000,547
17	Totali I kostove operative	5,359,677	4,530,864




Figura 2: Paraqitja skematike e kostove operacionale të propozuara nga NQ Termokos dhe të lejuara nga ZRRE-ja për sezonin e ngrohjes 2019/2020



Shpjegim analitik

Në vijim janë dhënë shpjegime të detajizuara dhe arsyetimet për përcaktimin / lejimin për secilin grup të kostove respektivisht për pozicionet kryesore të kostove operative.

Kostot variabile:

- **Kostoja e blerjes së energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B – komponenti i pagesës për sasinë e energjisë termike:**

- NQ Termokos ka propozuar koston totale të blerjes së energjisë termike nga kogjenerimi në vlerë prej 1,189,384 €. Kjo kosto është e bazuar në: kapacitetin e rezervuar sipas planifikimeve të Bilancit të energjisë dhe sasinë e planifikuar të energjisë termike, si dhe në çmimet përkatëse për kapacitet dhe sasisë së energjisë termike sipas marrëveshjes për shit-blerjen e energjisë termike KEK Gjenerimi – NQ Termokos.

Më konkretisht, Komponenti variabil i pagesës për sasinë e energjisë termike është bazuar në sasinë e planifikuar prej 251,248 MWh_{TH} dhe çmimin (ngarkesën) prej 1.39 €/MWh_{TH}.

- Vlerësimi – Propozimi i NQ Termokos vlerësohet se është kryesisht real dhe i bazuar. Duhet theksuar gjithashtu se është përfshirë edhe komponenta e pagesës për taksën vjetore të licencimit, e cila llogaritet bazuar në taksën vjetore të licencave për prodhimin e energjisë termike të përcaktuar sipas Rregullës për Taksat të nxjerrë nga ZRRE. Llogaritjet rezultojnë si në vijim:
 - Komponenti i pagesës për sasinë e energjisë termike: 349,235 €; dhe
 - Komponenti i pagesës për taksën vjetore të licencimit: 25,125 €.

Komponentët e lartë-përshkruar rezultojnë komponentën e pagesës për sasinë e energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B, në vlerë prej **374,360 €** e cila lejohej për sezonin 2019/2020 .

- Është e vlefshme të përmendet se kostoja e tërësishme e blerjes së energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B – që përshinë komponentën për kapacitetin e rezervuar dhe komponentën për sasinë e energjisë termike – është **1,189,384 €**.

- **Kostoja e lëndës djegëse – mazutit:**

- Kostoja e mazutit e propozuar nga Termokosi është bazuar në sasinë e parashikuar të shpenzimit të mazutit prej 710 ton dhe çmimin e blerjes prej 450 €/ton;
- Vlerësimi – Me funksionalizimin e projektit të kogjenerimit stabilimentet (kaldajat) e prodhimit të energjisë termike janë kapacitet rezervë për tu aktivizuar vetëm në rastet e ndërprerjeve të paplanifikuara (avarive) të stabilimenteve të TC Kosova B. Kështu që përdorimi i tyre eventual do të zgjaste për periudha të shkurtëra gjersa të kryhen riparimet e nevojshme. Duke marrë parasysh se konsumi mesatar ditor, bazuar në të dhënat historike (14 vjeçare) vlerësohet të jetë rreth 70 ton/ditë, atëherë vlerësohet se sasia e planifikuar prej 710 ton është mjaftueshme për të prodhuar energji termike për një periudhë dhjetë-ditore. Sa i përket çmimit të blerjes, duhet theksuar se çmimi i furnizimit të mazutit përbëhet nga çmimi aktual i tregut dhe ‘premiumi’ për të mbuluar shpenzimet e furnizuesit. Çmimi i blerjes ka marrë parasysh këto komponentë si dhe çmimin e furnizimit në sezonet e kaluara. Pra çmimi i mazutit është llogaritur si një mesatare e komponentëve të lartpërmendur, dhe ky



parashikim vlerësohet si real dhe i bazuar. Bazuar në sa u tha më lartë mund të vlerësohet se planifikimi për koston e mazutit propozuar nga NQ Termokos është real dhe lejon **koston e mazutit** në vlerë prej **319,500€**.

Lidhur me koston e mazutit për prodhimin vetanak të energjisë termike duhet theksuar se, edhe pse NQ Termokos nuk e ka paraqitur, ZRRE ka shtuar edhe koston për pagesën e taksës vjetore të licencimit. Kjo pagesë është llogaritur **1,364 €** bazuar në prodhimin e parashikuar të energjisë termike nga mazuti prej 6,820 MWh dhe taksën vjetore të licencimit 0.20 €/MWh (sipas Rregullës për taksat nxjerrur nga ZRRE).

- **Kostoja e ujit për (ri)mbushjen e sistemit të ngrohje:**

- NQ Termokos ka propozuar koston në vlerë prej 95,000 €, për sasinë e parashikuar të shpenzimit të ujit 57,500 m³ për rimbushje të sistemit të shpërndarjes (rrjetit primarë) si dhe koston për rimbushjen e rrjetit të transportimit të energjisë termike nga kogjenerimi dhe kostoja për shpenzimet e ujit në nënstacione.
- Vlerësimi – ZRRE ka kryer vlerësimet duke u bazuar realizimin e kësaj kostoje në sezonet e kaluara – konkretisht në sezonin 2018/2019 kostoja e ujit e realizuar ka qenë 96,953 € për konsumin e ujit prej 58,938 m³. Gjithashtu vlerësimet kanë marrë për bazë sasinë e parashikuar të ujit për rimbushje të rrjetit primar të shpërndarjes (57,500 m³ – konsum pak më i vogël se sezonin e kaluar për shkak të zvoglimit të paraparë të humbjeve në rrjet), si dhe kostot tjera të ujit për rrjetin e kogjenerimit dhe nënstacionet. Rrjedhimisht, bazuar në llogaritjet përkatëse që marrin parasysh edhe tarifatat aktuale të shërbimeve të ujit për KRU Prishtina – për shërbimin e ujësjellësit: 0.85 €/ m³ dhe për shërbimin e ujërave të zeza: 0.11 €/m³, vlerëson se kostoja e propozuar e ujit prej **95,000 €**, vlerësohet si reale dhe e mjaftueshme për sezonin 2019/2020.

- **Kostoja e kemikaljeve për trajtimin e ujit**

- NQ Termokosi ka propozuar koston e kemikaljeve për trajtimin e ujit në vlerë prej 40,000 €, që është kosto e rritur për 5,000 € në krahasim me koston e lejuar në sezonin e kaluar (2018/2019).
- Vlerësimi – Duke marrë parasysh sasinë e ujit që duhet trajtuar, rrjedhjet e ujit (humbjet) dhe rritjen e planifikuar të sipërfaqes për ngrohje, ZRRE vlerëson se vlera prej **35,000 €** është e mjaftueshme për të mbuluar koston e kemikaljeve për trajtimin e ujit.

- **Kostoja e energjisë elektrike**

- Për koston e energjisë elektrike NQ Termokos ka propozuar vlerën totale prej 549,199 € - kjo kosto merr parasysh konsumin e energjisë elektrike në impiantet e sistemit dhe në nënstacione. Duhet theksuar se vlera e propozuar e koston së energjisë elektrike paraqet një rritje prej afërsisht 10% krahasuar me vlerën e realizuar në sezonin e kaluar 2018/2019 (499,271 €). Kjo rritje është arsyetuar kryesisht me shtim të numrit të nënstacioneve për shkak të rritjes së bazës së konsumatorëve gjegjësisht shtimit të sipërfaqes ngrohëse dhe shtimin e pajisjeve të reja.
- Vlerësimi – ZRRE vlerëson se planifikimi i koston së energjisë elektrike është i bazuar dhe real dhe se rritja prej rreth 10% korrespondon me shtimin e numrit të nënstacioneve respektivisht sipërfaqes për ngrohje. Rrjedhimisht pranohet kostoja e paraqitur e energjisë elektrike në vlerë prej **549,199 €** si reale dhe e mjaftueshme për të mbuluar konsumin e



tërësishëm të energjisë elektrike për periudhën në fjalë, përfshirë edhe shpenzimet shtesë për shkak të rritjes së sipërfaqes ngrohëse dhe instalimit të pajisjeve shtesë (të reja).

- **Kostoja e Personelit (“puna direkte”)**

- NQ Termokos ka paraqitur koston e personelit – “puna direkte”, në vlerë prej 870,034 €, që paraqet një rritje prej rreth 8% në krahasim me vlerën e realizuar në sezonin e kaluar. Për këtë parashikim nuk kanë ofruar detaje të kërkuara në komentet me shkrim të ZRRE-së, përveç se është arsyetuar me faktin “që janë bazuar në pagat aktuale me një rritje të planifikuar prej 5%.”, që nuk korrespondon me të dhënat përkatëse që na janë dorëzuar për realizimet e sezonit të kaluar.
- Vlerësimi – Rritja e propozuar nga NQ Termokos nuk përmban detajet e nevojshme si: shtimin e numrit të punëtorëve, shtimin e pagave, pagën mesatare etj, që janë të domosdoshme për të arsyetuar rritjen e propozuar. Po ashtu nuk ka ndonjë zgjerim të dukshëm të operimeve të NQ Termokos që do implikonte shtim të dukshëm të numrit të punëtorëve. Duke pasur parasysh politikat aktuale, që pagat në sektorin publik duhet të reflektojnë rritjen ekonomike në shkallë vendi, ZRRE e vlerëson të arsyeshme rritjen e kësaj kostoje sipas rritjes së pritshme ekonomike për vitin 2019. Sipas projeksioneve të Bankës Botërore rritja e pritshme ekonomike për Kosovën është 4.4% (<https://dataworldbank.org/country/kosovo>). Bazuar në këtë ZRRE ka llogaritur koston e personelit me 4.4% rritje nga vlera e realizuar në sezonin e kaluar 2018/2019 (805,990 €); që rezulton në vlerën **841,454 €**, e cila lejohet për **Koston e personelit (‘puna direkte’)**.

- **Kostoja e Borxheve të këqija dhe taksa vjetore e licencimit**

- Siç theksohet më poshtë nën seksionin ‘kostot fikse’, NQ Termokos e ka futur këtë kosto nën pozicionin ‘kostot e shitjes dhe tjera administrative’ duke paraparë vlerën që korrespondon me rreth 10% të faturimit të planifikuar. Ndërsa për taksën e licencimit kanë paraqitur një vlerë mjaft të madhe që nuk korrespondon me sasinë e energjisë termike nga prodhimi vetanak – në stabilimentet e prodhimit me mazut në ngrohore.
- Vlerësimi - Në pajtim me dispozitat e Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, kostoja e borxhit të keq llogaritet si përqindje e arsyeshme në të hyrat e ndërmarrjes (d.m.th. vlerën e faturimit nga shitja e ngrohjes). Kjo ‘përqindje e arsyeshme’ duhet të caktohet në atë mënyrë që të nxis ndërmarrjen për të shtuar përpjekjet për rritjen e nivelit të arkëtimit të pagesave nga konsumatorët, por njëkohësisht merr parasysh se një shumë e konsiderueshme objektivisht nuk mund të arkëtohet, pra do të mbetet si borxh që faktikisht nuk do të realizohet. Nga sa u tha më lartë ZRRE mendon se niveli i borxhit të keq prej 5% është i arsyeshëm, dhe rrjedhimisht e lejon **koston e borxhit të keq** në vlerën prej **314,440 €**. Sa i përket taksës së licencimit ajo është llogaritur bazuar në sasinë e planifikuar të prodhimit vetanak 6,820 MWh_{TH} dhe taksës vjetore prej 0.20 €/MWh_{TH}, që rezulton në vlerën **1,364 €**.

Nga më lartë rezulton se **Kostot Variabile** të pranuar nga ZRRE-ja janë përcaktuar në vlerën **2,530,317€**.



Kostot fikse

- **Kostoja: Riparimet dhe Mirëmbajtja;**
 - NQ Termokos për koston e riparimeve dhe mirëmbajtjes ka planifikuar vlerën prej 210,800€ - një rritje shumëfish më e madhe krahasuar me realizimin e kësaj kostoje në periudhën e kaluar / sezonin 2018/2019 (39,333 €). Gjithashtu kjo vlerë e propozuar është mbi 100% më e madhe se vlera në pasqyrën financiare 2018 (80,704€). Për këtë rritje NQ Termokos ka dhënë një arsyetim të shkurtër ku thuhet se kanë planifikuar renovimin e objekteve ekzistuese, prandaj është paraparë një rritje për këtë pozicion.
 - Vlerësimi – Duke qenë se realizimet në sezonet e kaluara kanë qenë konsiderueshëm më të vogla për pozicionin ‘mirëmbajtja dhe riparimet’, dhe gjithashtu kjo rritje nuk është arsyetuar mjaftueshëm me të gjitha detajet e nevojshme, ZRRE vlerëson se vlera e propozuar nuk është e arsyeshme dhe nuk reflekton shpenzimet e zakonshme për riparimet dhe mirëmbajtjen që i shkaktohen ndërmarrjes. Megjithatë, duke marrë parasysh pjesërisht arsyetimin e cekur më lartë, si dhe nevojën për të siguruar operim të qëndrueshëm të stabilimenteve, pajisjeve dhe rrjetit që mundëson një furnizim cilësor, ZRRE lejon një rritje të konsiderueshme për **koston e riparimeve dhe mirëmbajtjes në vlerën prej 85,000 €.**
- **Kostoja: Materialet dhe Shërbimet:**
 - Për këtë pozicion nga NQ Termokos është propozuar vlera prej 110,200 €.; kjo vlerë paraqet rritje prej rreth 22% nga vlera e lejuar në shqyrtimin tarifor të sezonit të kaluar (86,500 €) respektivisht rreth 80% më e madhe krahasuar me realizimin e kësaj kostoje në periudhën e kaluar - sezoni 2018/2019 (60,676€).
 - Vlerësimi – Duke marrë parasysh se kjo kosto është ngushtë e ndërlidhur me koston e riparimeve dhe mirëmbajtjes, si dhe bazuar në krahasimet më lartë vlerësohet se rritja e propozuar nga NQ Termokos nuk reflekton shpenzimet e realizuara në sezonet e kaluara. Rrjedhimisht ZRRE lejon koston ‘**Materialet dhe Shërbimet**’ në vlerë prej **86,500 €.**
- **Kostoja e blerjes së energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B – komponenti fiks i pagesës për kapacitetin e rezervuar**
 - Komponenti i pagesës për kapacitet të rezervuar e propozuar nga NQ Termokos ka është bazuar në kapacitetin e rezervuar elektrik: 38,300 MWh_{EL}/h dhe ngarkesën respektive: 21.28 €/MWh_{EL}/h;
 - Vlerësimi – Propozimi i NQ Termokos për kapacitetin e rezervuar vlerësohet është kryesisht real dhe i bazuar në Bilancet e energjisë; nga llogaritjet rezulton se komponenti i **pagesës për kapacitetin e rezervuar është 815,024€;**
- **Kostot Administrative:**
 - NQ Termokos ka propozuar koston për administratë në vlerë prej 115,900 € duke ofruar detajimet përkatëse. Vlera e propozuar tregon rritje prej 53% krahasuar me vlerën e realizuar në periudhën e kaluar (75,698 €).
 - Vlerësimi – Bazuar në sa u përmend më lartë dhe për të lejuar përmirësimin e shërbimeve të ndërmarrjes e veçanërisht shërbimin për konsumatorë, ZRRE vendos të lejoj një rritje të



vogël (rreth 8%) nga realizimi në periudhën e kaluar dhe e fikson këtë kosto në vlerën **82,000€**.

- **Kostoja e Personelit ('e ndryshme prej punës direkte')**

- Për koston e personelit në administratë dhe shërbimet tjera mbështetëse NQ Termokos ka propozuar vlerën prej 920,851 € - propozim i rritur 28% në krahasim me realizimin e kësaj kostoje në sezonin e kaluar (718,015 €). Njëjtë si për koston e personelit 'puna direkte', për këtë parashikim nuk kanë ofruar detaje të kërkuara në komentet me shkrim të ZRRE-së, përveç se është arsyetuar me faktin "që janë bazuar në pagat aktuale me një rritje të planifikuar prej 5%.", që nuk korrespondon me të dhënat përkatëse që na janë dorëzuar për realizimet e sezonit të kaluar.
- Vlerësim – Rritja e propozuar nga NQ Termokos nuk përmban detajet e nevojshme si: shtimin e numrit të punëtorëve, shtimin e pagave, pagën mesatare etj, që janë të domosdoshme për të arsyetuar rritjen e propozuar. Po ashtu, nuk ka ndonjë zgjerim të dukshëm të operimeve të NQ Termokos që do implikonte shtim të dukshëm të numrit të punëtorëve. Duke pasur parasysh politikat aktuale, që pagat në sektorin publik duhet të reflektojnë rritjen ekonomike në shkallë vendi, ZRRE e vlerëson të arsyeshme rritjen e kësaj kostoje sipas rritjes së pritshme ekonomike për vitin 2019. Sipas projeksioneve të Bankës Botërore rritja e pritshme ekonomike për Kosovën është 4.4% (<https://dataworldbank.org/country/kosovo>). Bazuar në këtë ZRRE ka llogaritur koston e personelit me 4.4% rritje nga vlera e realizuar në sezonin e kaluar 2018/2019 (718,015 €); që rezulton në vlerën e lejuar prej **749,608 €**.

- **Kostot e shitjes dhe tjera administrative**

- Kjo kosto është propozuar nga NQ Termokos në vlerë tejet të madhe 938,809 €; nga detajimet e ofruara vërehet se pjesa kryesore i takon nën-komponentës "shpenzimet e provizioneve të llogarive të arkëtueshme" në vlerë prej 641,132 €. Po ashtu nga detajimet vërehet nën-komponenti "kontributet për sigurim pensional" ku është paraqitur një vlerë mjaft e madhe prej 89,554 €, si dhe "shpenzimet për licencë të shpërndarjes së ngrohjes" në vlerë 25,718 €.
- Vlerësimi – Nga sqarimet e NQ Termokos kuptohet se këto vlera të rritura janë të ndërlidhura me shlyerjen e borxheve gjer në vitin 2008 në përputhje me Ligjin për faljen e Borxheve Publike. ZRRE e vlerëson këtë si një operacion kontabël i domosdoshëm për të reflektuar shlyerjen e borxheve sipas ligjit në fjalë; dhe rrjedhimisht këto kosto nuk i konsideron si subjekt të shqyrtimit tarifor. Gjithashtu duhet potencuar faktin se në përputhje me dispozitat e Rregullës për vendosjen e çmimeve të energjisë termike, ZRRE e përcakton / lejon një përqindje të arsyeshme të nivelit të borxheve të këqija, e cila është kategorizuar nën kostot variable si kostoja e borxheve të këqija. Ndërsa për komponentën "kontributet për sigurim pensional" ZRRE konsideron se kjo vlerë i përket dhe alokohet tek 'kostoja e personelit'. Gjithashtu komponenta e taksës së licencimit nuk reflekton vlerën e prodhimit të energjisë në stabilimentet e ngrahores, dhe e cila është alokuar nën 'kostot tjera variable'.
- Nga sa u tha më lartë, ZRRE ka fiksuar vlerën **182,415 €**, e cila nuk i përfshin komponentët e lartpërmendur, si vlerë e lejuar për Kostot e shitjes dhe tjera administrative.

Nga më lartë rezulton se **Kostot Fikse** të pranuar nga ZRRE-ja, janë përcaktuar në vlerën **2,000,547€**.



- Total Kostot operative të lejuara për sezonin 2019/2020

Kostot operacionale të lejuara përbëhen nga shuma e kostove fikse dhe atyre variabël, dhe janë llogaritur sipas formulës së shënuar më poshtë:

OC = Kostot Variabile + Kostot Fikse

Nga formula llogariten:

Kostot operative të lejuara në vlerë prej 4,530,864 €

3.2 Përcaktimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB)

Përcaktimi i RAB-it është faktori kryesor për llogaritjen e Zhvlerësimit vjetor dhe Kthimit të lejuar në asete, që në fakt paraqet fitimin e lejuar nga aktiviteti afarist i rregulluar.

Baza e Rregulluar e Aseteve - RAB, në pajtim me shtojcën 2 të Rregullës për vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike llogaritet sipas formulës:

$$RAB_n^{përf.} = RAB_n^{fill.} + INV_n + WC_n - DEP_{n-1} - DIS_{n-1}$$

ku:

$RAB_n^{përf.}$ – paraqet asetet e planifikuara për sezonin 2019/20 ('n);

$RAB_n^{fill.}$ – Bazën e Rregulluar të Aseteve fillestarë, që faktikisht paraqet RAB-in përfundimtarë të realizuar në sezonin paraprak 2018/19 (n-1);

INV_n – Investimet e reja të planifikuara dhe të aprovuara nga rregullatori për periudhën njëvjeçare që përfshinë sezonin e ngrohjes 2019/2020;

WC_n – Kapitali i mjaftueshëm punues për kompaninë që të kryejë aktivitetet e saj;

DEP_{n-1} – Zhvlerësimin e asetëve të realizuar në sezonin paraprak 2018/19 (n-1); dhe

DIS_{n-1} – Asetet e tjetërsuara në sezonin paraprak 2018/2019 (n-1).

3.2.1 Përcaktimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve Fillestarë (RABnfill.)

$RAB_n^{fill.}$ paraqet bazën fillestare për përcaktimin e RAB-it të planifikuar për sezonin 'n' – 2019/20, e që, siç u theksua më lartë, faktikisht është RAB-i përfundimtarë i realizuar në sezonin paraprak 'n-1' – 2018/19.

Nga monitorimi i rregullt i realizimeve, ku kryesisht fokusi është në monitorimin e realizimit të investimeve në raport me ato të planifikuara (Raporti i Monitorimit të realizimeve për sezonin 2018/2019), janë konstatuar vlerat e realizuara prej nga llogaritet RAB përfundimtarë i realizuar në sezonin 'n-1' – 2018/19 në vlerë **41,318,686 €**, që njëkohësisht paraqet RAB-in fillestarë për sezonin 'n' -2019/20.

3.2.2 Përcaktimi i Investimeve të reja të lejuara

Lidhur me Investimet e reja të planifikuara për periudhën e shqyrtimit tarifor: tetor 2019 – tetor 2020, fillimisht duhet theksuar se këto investime kryesisht i përkasin rehabilitimit të rrjetit e nënstacioneve, si dhe zgjerimit të rrjetit dhe nëstacione të reja; Vlera totale e **investimeve të reja të planifikuara** është **11,152,000 €**; në këtë shumë janë përfshirë investimet nga donacionet dhe investimet me vet-financim.



Investimet nga donacionet

Investimet në kuadër të projekteve të donatorëve ndërkombëtarë si Komisioni Evropian, KfW dhe MCC janë paraqitur në vlerë totale prej **9,772,000 €** – pra këto projekte planifikohen në pjesën më të madhe të financohen nga donacionet, ndërsa një shumë e vogël me vetëfinancim – detajet në vijim:

- Projekti i Komisionit Evropian IPA 2015: Rehabilitim i rrjetit e nënstacioneve, si dhe zgjerim i rrjetit dhe nënstacione të reja, është planifikuar në vlerë totale prej 8.3 milion €. Komponentet kryesore të këtij projekti paraqiten të pëmbledhura në vijim:
 - Rehabilitimi i rrjetit të shpërndarjes (zëvendësimi i tubacioneve të vjetra me gypa të rinjë të paraizoluara) – 3.28 km trase respektivisht 6.5 km tubacion; rehabilitimi përfshin rajonet: Qendër: 1 km trase, Dardani: 0.79 km trase, Kodra e Diellit: 1.18 km trase, Ulpiana 0.24 km trase dhe Kalabri një segment shumë i shkurtër prej vetëm 0.07 km.
 - Rehabilitimi i 100 nënstacioneve termike – Dardania: 26, Qendra: 9, Ulpiana: 21, Kodra e Diellit: 8, QKUK: 5 dhe Institucione të ndryshme: 31 nënstacione termike.
 - Zgjerimi i rrjetit në total 3.96 km trase respektivisht 7.92 km tubacioni i ri – Qendra: 0.66 km trase, Kodra e Diellit: 0.048 km trase, 0.574 km trase, Dardania: 0.617 km trase, Kalabria: 1.028 km trase dhe Mati: 1.035 km trase.
 - 50 Nënstacione termike të reja – Qendra: 9, Ulpiana: 4, Kalabria: 31, Mati: 5 dhe 1 Nënstacion termik i Objektivit i drejtorisë së Doganave të Kosovës.

Në kuadër të këtij projekti, gjatë periudhës së shqyrtimit tarifor, duke u bazuar në planin dinamik të zhvillimit të projektit, parashihet realizimi i një pjese të konsiderueshme të komponentëve të lartë-përmendura në vlerë prej **5,672,000 €**.

- Projekti i KfW: Rehabilitimi i rrjetit dhe nënstacioneve, si dhe zgjerim të rrjetit dhe nënstacione termike të reja është planifikuar në vlerë totale rreth 14 mil €, nga cila shumë gjatë periudhës 2018/19 janë realizuar rehabilitim i disa segmenteve të rrjetit në vlerë 1.5 mil €. Ky projekt përfshinë komponentet:
 - Rehabilitim i rrjetit dhe nënstacioneve termike;
 - Zgjerim i rrjetit dhe nënstacione të reja termike;
 - Ndërtimi i Rezervuarëve të ngrohjes.

Lidhur me komponentet e latë-përshkruara duhet theksuar se nuk janë dhënë detaje të hollësishme sepse aktualisht është në përgaditje e sipër specifikacioni teknik për të filluar pastaj me procedurat e tenderimit të punimeve për realizim të projektit.

Gjatë periudhës së shqyrtimit tarifor planifikohet realizimi i punimeve në vlerë prej **2.5 mil. €**.

- Projekti i MCC: Instalimi i matësve të energjisë termike - Ky projekt në vlerë të paraparë prej 10.9 mil \$, si donacion nga MCC – SHBA, përmban:
 - Instalimin e matësve individual të energjisë termike respektivisht alokatorëve të nxehtësisë;
 - Instalimin e valvulave termostatike dhe pompave qarkulluese;
 - Zhvillimin e softverit për faturim dhe lexim të konsumit të energjisë termike;
 - Asistencë në përmirësimin e shërbimeve të faturimit bazuar në konsumin e matur.

Planifikohet që gjatë periudhës së shqyrtimit tariforë punimet të realizohet në vlerën **1.5 mil.€**.

- Projekti i KfW-EBRD: Stabilimentet e prodhimit të energjisë termike nga panelet solare – ky projekt është në fazën fillestare ideore dhe në kuadër të këtij projekti është paraqitur vlera prej **100,000€** për hartimin e studimit të fizibilitetit



Investimet me vet-financim

Siç u përmend më lartë, NQ Termokos planifikon edhe investime me financim vetanak në vlerë totale prej **1,380,000 €**; nga këto investime vetanake një pjesë janë në kuadër të projekteve rehabilituese të lartpërmendura ndërsa pjesa tjetër janë investime individuale – detajet në vijim:

- Rehabilitim të rrjetit dhe pajisjeve përkatëse në vlerë prej 494,000 €;
- Pajisje të impianteve në vlerë 284,000 €;
- Ndërtimi i Ndërtesës së Drejtorisë dhe Administratës në vlerë prej 530,000 €; dhe
- Pajisje kompjuterike dhe program kompjuterike në vlerë 72,000 €.

Përmbledhje e Investimeve të reja të lejuara

ZRRE ka përcjellur në vazhdimësi zhvillimin e këtyre projekteve investive dhe në kuadër të bashkëpunimit me palët e kyçura në këto projekte është informuar saktësisht për detajet e këtyre projekteve. Duhet theksuar se të gjitha projektet e paraqitura janë të përshira gjithashtu në Planin Zhvillimorë 2019 – 2029 të NQ Termokos, i cili është aprovuar nga ZRRE.

Një numër i këtyre projekteve posaqërisht të projekteve nga donatorët ka kohëzgjatjen mbi një vit, kështu që ka qenë e nevojshme vlerësimi i punimeve që planifikohen të realizohen brenda periudhës së shqyrtimit tarifor, që vlerësohet se kryesisht ka qenë i bazuar në planet dinamike të realizimit të këtyre projekteve. Prandaj ZRRE pranon shumicën e projekteve / investimeve të reja të planifikuara dhe vlerat respektive me përjashtim të:

- Projektit të KfW-EBRD-së: Stabilimentet e prodhimit të energjisë termike nga panelet solare – ky projekt është në fazën fillestare përgatitore (fazën studimore) dhe se duhet të kaloj nëpër faza tjera të zhvillimit të projekti që natyrisht se marrin kohë. Prandaj ZRRE e vlerëson të parakohëshëm paraqitjen e vlerës për hartimin e Studimit të fizibilitetit, që mendojmë se duhet të paraqiten në fazat e mëvonshme të progresit të projektit. Rrjedhimisht ZRRE në këtë fazë nuk e pranon që vlera e propozuar prej 100,000 € të përfshihet në RAB për këtë periudhë të shqyrtimit tarifor.

Në Investimet e reja me vetëfinancim, ndër tjera, është planifikuar edhe ndërtimi i ndërtesës të zyrës qendrore administrative të NQ Termokos në vlerë prej 530,000 €. Lidhur me këtë investim duhet theksuar se realizimi i këtij projekti është ngusht i ndërlidhur me përcaktimin e lokacionit dhe procedurave administrativo-ligjore për marrjen e pëlqimit/kushteve ndërtimore-urbanistike si hapa paraprës në zhvillimin e projektit detal dhe marrjen lejes ndërtimore. Sipas konfirmimit nga NQ Termokos janë ndërmarrë masa për përcaktimin e lokacionit në bashkëpunim të ngushtë me Komunën e Prishtinës ku është lëshuar vendimi për bashkimin e parcelave për lokacionin e ndërtimit. Gjithashtu është në vijim faza tenderuese për hartimin e Projektit ideorë ma paramasat e ndërtimit planin e zhvillimit të projektit (pritet të kryhet në fund të tetorit 2019), i cili do të shërbej mëtutje për hartimin e projektit detal ndërtimor dhe për procedurat e tenderimit për përzgjedhje të kryesit të punimeve; sipas planit dinamik punimet parashihen të fillojnë në mars 2020. Duke marrë parasysh sa u tha më lartë ZRRE, për këtë periudhë njëvjeçare të shqyrtimit tarifor, pranon vlerën e propozuar prej **530,000€**.

Bazuar në vlerësimet e paraqitura më lartë ZRRE pranon Investimet e reja të planifikuara në vlerë totale prej **11,052,000 €**



Ndarja sipas mënyrës së financimit:

Duke ju referuar detajeve të financimit të përshkruara më lartë ndarja e Investimeve të reja të lejuara sipas mënyrës së financimit është si më poshtë:

- (Investimet e reja të lejuara)_{DONACION} = 9,672,000 €; dhe
- (Investimet e reja të lejuara)_{VETFINANC.} = 1,380,000 €.

3.2.3 Përcaktimi i Kapitalit Punues

Sipas dispozitave përkatëse të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike – Shtojca 2, kapitali punues zakonisht përcaktohet për të lejuara mjete monetare qarkulluese për një periudhë jo më të gjatë se një muaj respektivisht vlerën e të hyrave mesatare mujore. Rrjedhimisht, ZRRE përcakton raportin 1/12 në të hyrat nga shitja e ngrohjes të realizuara në sezonin 2018/2019 – 6,288,796 €, dhe lejon **kapitalin punues** në vlerën **524,066 €**.

3.2.4 Zhvlerësimi Vjetorë i Aseteve - realizuar në sezonin 2018/19 ('n-1')

Zhvlerësimi vjetorë i realizuar në sezonin 'n-1' – 2018/19 llogaritet duke u bazuar në Bazën e Aseteve të Rregulluar (RAB) të realizuar në atë sezon dhe mesataren e ponderuar të normës së zhvlerësimit; më konkretisht, nga Vlera e RAB të realizuar në 2018/19 (41,318,686 €) zbritet vlera e kapitalit punues të realizuar (503,067 €), dhe shuma e fituar (40,815,619 €) shumëzohet me mesataren e ponderuar të normës së zhvlerësimit (3.34%). Pra nga kjo llogaritet Zhvlerësimi vjetor i realizuar në sezonin 2018/19 në vlerën 1,363,692 €.

3.2.5 Tjetërsimet

Me tjetërsim nënkuptohen asetet që ndërmarrja e rregulluar i ka hequr nga përdorimi – asetet që janë dëmtuar në atë masë sa që nuk mund të riparohen dhe të përdoren përsëri, asetet që eventualisht janë shitur/huazuar (kur janë vlerësuar të papërdorshme) etj; Sipas formulës së dhënë në fillim të kapitullit 3.2, vlera e asetëve të tjetërsuara është e zbritshme (minusohet). Duke qenë se në këtë shqyrtim tarifor nuk është raportuar ndonjë tjetërsim i asetëve, vlera për tjetërsimet është 0€.

Përmbledhje e përcaktimit të RAB-it dhe RAB_f

Në tabelën vijuese paraqiten të përmbledhura komponentet përbërse dhe vlerat respective të Bazës së Rregulluar të Asetëve (RAB) dhe Bazës së Rregulluar të Asetëve të vetëfinancuara (RAB_f).



Tabela 2: RAB dhe komponentët e tij - NQ TERMOKOS sezoni i ngrohjes 2019/2020

Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB) - NQ TERMOKOS Sezoni i ngrohjes 2019-2020		Lejuar nga ZRRE [€]
3.2.1	Baza e Rregulluar e Aseteve fillestarë ($RAB_n^{fill.}$)	41,318,686
3.2.2	Investimet e Reja (INV_n)	11,052,000
3.2.3	Kapitali Punues (WC_n)	524,066
3.2.4	Zhvlërimi Vjetorë i Aseteve – realizuar në sezonin 2018/19 (DEP_{n-1})	-1,363,692
3.2.5	Tjetërsimet e asetëve – në sezonin 2018/19 (DIS_{n-1})	0
	Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB)	51,531,060

Lidhur me Bazën e Rregulluar të Aseteve të vetëfinancuara (RAB_f) duhet theksuar se vlejën të njëjtat formulime si për RAB-in e përgjithshëm, porse këtu merren vlerat e asetëve të vetëfinancuara; detajet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3: RAB_f dhe komponentët e tij - NQ TERMOKOS sezoni i ngrohjes 2019/2020

Baza e Rregulluar e Aseteve e vetëfinancuar (RAB_f) - NQ TERMOKOS Sezoni i ngrohjes 2019-2020		Lejuar nga ZRRE [€]
3.2.1	Baza e Rregulluar e Aseteve të vetëfinancuara - fillestarë ($RAB_{f-n}^{fill.}$)	8,488,760
3.2.2	Investimet e Reja (të vetëfinancuara - pa donacione) (INV_{f-n})	1,380,000
3.2.3	Kapitali Punues (WC_n)	524,066
3.2.4	Zhvlërimi Vjetorë i Aseteve të vetëfinancuara – realizuar në sezonin 2018/19 (DEP_{f-n-1})	-228,163
3.2.5	Tjetërsimet e asetëve të vetëfinancuara - në sezonin 2018/19 (DIS_{n-1})	0
	Baza e Rregulluar e Aseteve e vetëfinancuar (RAB_f)	10,164,663

3.3 Vlerësimi dhe Përcaktimi i Zhvlërsimit Vjetor për sezonin 2019/2020

Përcaktimi i Zhvlërsimit vjetor për sezonin 2019/20 ('n') bazohet në vlerën e RAB-it total të përcaktuar në tabelën '2' (kapitulli '3.2') dhe në mesataren e ponderuar të normës së zhvlërsimit sipas kategorizimit të asetëve, të paraqitur në tabelë e mëposhtme '4' dhe vlerave përkatëse të dhënë tabelën 2. Në tabelën 4 është dhënë në mënyrë të përmblodhur kategorizimi i RAB-it sipas kategorive të asetëve, jetëgjatësia respektive gjegjësisht norma e zhvlërsimit për secilën kategori të asetëve, si dhe norma mesatare e ponderuar e zhvlërsimit.



Tabela 4: Kategorizimi i Aseteve (RAB) dhe norma mesatare e ponderuar e zhvlerësimit

Normat e Zhvlers. / Mesat. e Ponder. E Normës së Zhvlers. - Invest. e Reja			
Toka	Jetëgjat. E asetit	Vitet	N/A
	Norma e Zhvlerësimit	%	0
Ndërtesat	Jetëgjat. E asetit	Vitet	35
	Norma e Zhvlerësimit	%	2.86%
	Vlera Investimit	Euro	0
Stabilimentet, pajisjet dhe instalimet elektro-mekanike	Jetëgjat. E asetit	Vitet	25
	Norma e Zhvlerësimit	%	4.00%
Rrjeti - Tubacionet, fittingjet dhe pajisjet përbërëse	Jetëgjat. E asetit	Vitet	35
	Norma e Zhvlerësimit	%	2.86%
Pajisjet TI, instrumentet e sist. Kontroll., dhe invent. imët i zyrës	Jetëgjat. E asetit	Vitet	5
	Norma e Zhvlerësimit	%	20.00%
Total Investimet e Reja	Jetëgjat. E asetit	Vitet	N/A
	Mesat. Pond. Normës Zhvlers.	%	2.86%
Mesat. Pond. Normës Zhvlers. (Asetet Operative Ekzist + Investimet e Reja)		%	3.24%

Siç vërehet nga tabela më lartë norma mesatare e ponderuar e zhvlerësimit (NZH_{MP}) është llogaritur 3.24%. Bazuar në vlerën totale të (RAB-it minus Kapitali punues) dhe Normën mesatare të ponderuar të zhvlerësimit, llogaritet Zhvlerësimi vjetor i lejuar, si në vijim:

$$\text{Zhvlerësimi vjetor i lejuar (DEP}_n\text{)} = (\text{Total RAB} - \text{WC}_n) * \text{NZH}_{MP} = 51,006,994 \text{ €} * 3.24 \% = \mathbf{1,652,974\text{€}}$$

3.4 Përcaktimi i Kthimit të Lejuar në RAB (Fitimi i Lejuar)

Siç u përmend më parë, llogaritja/përcaktimi i Kthimit të lejuar llogaritet bazuar në Bazën e Rregulluar të Aseteve të vetëfinancuara RAB_f) dhe Normën e kthimit (RoR), pra përfshin dy komponentët në vijim:

- Përcaktimin (vendosjen) e Bazës së Rregulluar të Aseteve të vetëfinancuar (RAB_f); dhe
- Llogaritjen e Normës së Kthimit të lejuar (RoR), të përcaktuar në vlerën e WACC-ut.

Komponenta e parë - RAB_f është llogaritur në kapitullin 3.2 – tabela '3', ndërsa llogaritja e komponentës së dytë – RoR përcaktohet në kapitullin vijues:

3.4.1 Llogaritja e Normës së Kthimit (RoR) të Lejuar

Objektivi i Normës së kthimit të arsyeshme (RoR) në Bazën e rregulluar të asetëve (RAB), është që të garantoj ndërmarrjet e ngrohjes qendrore për një fitim që lejon të vazhdohet me investimet në asete, në mënyrë që të mund ti rehabilitoj dhe ti zgjeroj ato.

Një RoR i arsyeshëm konsiderohet të jetë norma e “Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit” (WACC), që llogaritet në komponentët e bazës së kapitalit, duke marrë parasysh ponderimet e shumave të këtyre komponentëve të kapitalit. Me fjalë tjera, WACC-u është shuma e mesatares së ponderuar të kostos së ekuitetit dhe kostos së borxhit.

Për koston e ekuitetit, ZRRE-ja ndjek metodologjinë e njohur ndërkombëtare të quajtur “Modeli i Çmimit të Kapitalit të Aseteve” (CAPM). CAPM shpreh koston e pritur të ekuitetit si një normë pa rrezik (r_f) plus premiumin e rrezikut të ekuitetit (ERP). Ne mund ta definojmë ERP si ndryshimin mes



rrezikut të tregut të ekuitetit – d.m.th. kthimi i pritur nga tregu i zhvilluar mirë – dhe normën e kthimit pa rrezik, e që shprehet me formulën e paraqitur më poshtë:

$$\text{ERP} = (r_m - r_f)$$

Norma e ERP varet nga rreziku i investimit në një treg të një vendi të veçantë.

Vlera e WACC-ut para tatimeve mund të llogaritet sipas formulës në vijim:

$$\text{WACC}_{\text{pre-tax}} = [(D/V) * k_d] + [(E/V) * k_e]$$

ku:

D/V	Raporti i borxhit ndaj totalit të bazës së kapitalit (si përqindje)
E/V	Raporti i ekuitetit ndaj totalit të bazës së kapitalit (si përqindje)
V	Totali i bazës së kapitalit, që është shuma e ekuitetit dhe borxhit
k_d	Kostoja e Borxhit
k_e	Kostoja e Ekuitetit

Kostoja e borxhit (k_d) është zotim kontraktual dhe është norma interesit që ndërmarrja paguan në huatë (kreditë) aktuale.

Kostoja e ekuitetit (k_e) llogaritet si në vijim:

$$k_e = r_f + \beta_e * (r_m - r_f)$$

ku:

r_f	Norma pa rrezik dhe nxjerret nga vlerësimet për kthimin në obligacionet (“bondet”) e qeverisë
β_e	“Beta”: masa e rrezikut për kompaninë përkatëse
(r_m - r_f)	Premiumi i rrezikut të tregut të ekuitetit minus norma e kthimit pa rrezik

“Premiumi i rrezikut” është përcaktuar nga “beta” dhe nga premiumi i rrezikut të pritur të një tregu, e që investitorët e kërkojnë nga tregu si tërësi. Faktori “beta” matë pa-parashikueshmërinë e kthimit të një kompanie në relacion me tregun e mallrave (aksioneve) si tërësi.

Më poshtë ne vlerësojmë / llogarisim koston e borxhit dhe koston e ekuitetit për ndërmarrjet e ngrohjes qendrore në Kosovë, për të ardhur tek WACC para tatimeve.

Kostoja e Borxhit

Për këtë sezon të ngrohjes dhe sezonet vijuese, ZRRE-ja ka vendosur që raporti D/V në vlerën 60/100 (60% borxh dhe 40% ekuitet). Ky raport 60% duhet të përdoret në vlerësimet / llogaritjet e WACC-ut komercial para tatimeve për sezonin e ngrohjes 2019/2020, si dhe për sezonet vijuese, nëse nuk vërehen ndryshime domethënëse.

Aktualisht NQ Termokos ka huan nga KfW me normë interesi 8.79% për investimet në projektin e kogjenerimit. Lidhur më këtë duhet theksuar se pjesa më e madhe e investimeve të projektit të



kogjenerimit ka qenë donacione (nga Qeveria Gjermane, Komisioni Evropian dhe nga Institucionet vendore qendrore dhe lokale); përderisa shuma prej 5,000,000 € është kredi nga KfW me normë interesi vjetor prej 8.97 % dhe afat kthimi 11 vjet. Rrjedhimisht kostoja e borxhit do te reflekton kredinë aktuale dhe fiksohet në vlerën **8.79 %**

Pra Kostoja e borxhit është:

$$k_d = 8.79 \%$$

Kostoja e Ekuitetit

Kostoja e ekuitetit paraqitet me formulën më poshtë:

$$k_e = r_f + \beta_e * (r_m - r_f)$$

ku:

$$(r_m - r_f) = \text{ERP} - \text{Premiumi i Rrezikut në Ekuitet}$$

Norma pa Rrezik ("Risk Free Rate - r_f) aktualisht, bazuar në trendet financiare vendore dhe ndërkombëtare të obligacioneve qeveritare (bonove të thesarit) vlerësohet në rangun prej 1.1 deri 3.0%. Kufiri i ulët përfaqëson nivelin e interesave për bonot e thesarit afatgjatë të Kosovës përderisa kufiri i lartë përfaqëson mesataren 10 vjeçare interesave nga bonot e thesarit të Hungarisë – që përfaqëson emetuesin më të rrezikshëm të borxhit të tregtuar afatgjatë në mesin e krahasuesve rajonal. Bazuar në këtë ZRRE e fikson **Normën pa Rrezik** në vlerën **2.3 %**.

Vendimet e fundit të autoriteteve rregullative e vlerësojnë premiumin e rrezikut në ekuitet në rangun prej 3.5 gjer në 5%. Për shkak se NQ Termokos është ndërmarrje publike konsiderohet se rreziku në ekuitet është minimal dhe rrjedhimisht përvetësohet që vlera e **ERP-së të jetë e barabartë me 4.5%**.

Beta mesatare e asetëve për rrjetet e energjisë elektrike në BE dhe për ndërmarrjet e integruara është 0.42 e krahasuar me 0.54 - 0.63 për ndërmarrjet që kanë vetëm gjenerimin dhe furnizimin në BE dhe SHBA. Për shkak se industria e ngrohjes qendrore në Kosovë është e vogël, duket e arsyeshme që të supozojmë se rritja e kërkesës – që është faktori kryesor për rritjen e të ardhurave – do të jetë më e pa-parashikueshme se sa rritja e GDP – që është faktori kryesor për rritjen e tregut të mallrave dhe aksioneve – se sa në vendet e mëdha dhe të zhvilluara. Shtimi i një konsumatori të vetëm të madh në ngrohjen qendrore do të thotë rritjen e kërkesës për ngrohje qendrore në krahasim me kërkesën e mëparshme, përderisa ndikim në GDP mund të jetë shumë më i vogël. Në mënyrë që ta marrin në konsideratë natyrën më të pa-parashikueshme të të ardhurave të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore në krahasim me rritjen e GDP, ne vlerësojmë që kostoja e ekuitetit të jetë më e lartë se sa mesatarja e vendosur nga rregullatorët e BE-së, dhe ne konsiderojmë se " β_e " e arsyeshme për ndërmarrjet e ngrohjes qendrore në Kosovë të jetë **$\beta_e = 1$** .

Kostoja e ekuitetit pas tatimeve është si në vijim:

$$k_{e \text{ post tax}} = 2.3\% + (1 * 4.5\%) = 6.80\%$$

Kostoja e ekuitetit para tatimeve gjendet duke shumëzuar rezultatin më lartë të koston së ekuitetit pas tatimeve me relacionin që e konsideron tatimin ("tax wedge") si më poshtë:



'Tax wedge' = 1/(1-t)

ku:

t Shkalla e tatimit në fitimin e kompanive

Tatimi në fitim (t) në Kosovë është 10% dhe relacioni që e konsideron tatimin ("tax wedge") është:

$$1/(1-0.10)= 1.11$$

Kostoja e ekuitetit para tatimeve është:

$$k_{e \text{ pre-tax}} = 6.80\% * 1.11 = 7.55 \%$$

Si rrjedhim i llogarive më lartë llogaritet WACC-u para tatimeve – i rrumbullakuar në dy decimale – si më poshtë:

$$WACC_{\text{pre-tax}} = [8.79\% * 0.6] + [7.55\% * 0.4] = 8.30\%$$

Llogaritja e Kthimit të Lejuar në RAB_f për NQ Termokos

Bazuar në $WACC_{\text{pre-tax}}$ e llogaritur prej 8.30% në 3.4.1, llogaritet Kthimi i lejuar apo Profiti i lejuar për NQ Termokos, sipas formulës më poshtë:

$$RET = RoR \times RAB_f$$

Pra Kthimi i lejuar në RAB_f është i barabartë me $10,164,663\text{€} * 8.30\% = 843,283 \text{€}$.

Tabela 5: Kthimi i Lejuar (Profiti i Lejuar) në RAB_f për NQ TERMOKOS për sezonin e ngrohjes 2019/2020

Kthimi i Lejuar në RAB _f për NQ TERMOKOS		Lejuar nga ZRRE [€]
RAB _f	Baza e Rregulluar e Aseteve - vetëfinancuar	10,164,663
RoR	Norma e Kthimit në vlerën e WACC	8.30%
	Kthimi i Lejuar në RAB _f	843,283



3.5 Përcaktimi i Kostos së Humbjeve në Rrjet

Kostoja e lejuar e humbjeve të rrjetit shërben për të mbuluar kostot që i shkaktohen ndërmarrjes për shkak të humbjeve të energjisë termike gjatë transportit dhe shpërndarjes. Në përputhje me Shtojcën 1 të Rregullës për Vendosije e Çmimeve të Energjisë Termike kjo kosto llogaritet si herësi në mes të humbjeve sasiore të rrjetit dhe gjenerimit të energjisë termike që hyn në rrjet (niveli në përqindje të humbjeve të tërësishme në rrjet), kjo e shumëzuar me koston e përgjithshme variabile të gjenerimit duke mos përfshirë komponentin variabil të koston së energjisë termike nga kogjenerimi.

Nga sa u tha më lartë ZRRE, ka zhvilluar Bilancin e energjisë termike të NQ Termokos për sezonin 2019/2020, përmes së cilit ka përcaktuar humbjet sasiore të rrjetit **22,075 MWh** – që është shuma e humbjeve sasiore në rrjetin e transportit TC Kosova B – NQ Termokos (5,025 MWh) dhe humbjeve sasiore në rrjetin e shpërndarjes (17,050 MWh). Shprehur në përqindje, niveli i përgjithshëm i humbjeve në rrjet është 8.76% - niveli i humbjeve në rrjetin e transportit: 2.0% dhe niveli i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes 6.76%. Gjithashtu nga Bilanci i energjisë termike është derivuar sasia e prodhimit (gjenerimit) neto dhe blerjeve neto të energjisë termike – në sasi totale 252,223 MWh.

Bazuar në vlerat më lartë dhe në koston variabile operative (2,530,317 €) llogaritet **Kostoja e humbjeve** në rrjet në vlerën **221,461 €**.

3.6 Përshtatja (Akhustimi)

Përshtatja (axhustimi) shërben për të korrigjuar ndryshimet eventuale mes planifikimeve të shqyrtimit tarifar për periudhën (sezonin) 'n-1' dhe realizimeve që faktikisht kanë ndodhur në atë periudhë (sezon) dhe ato ndryshime përfshihen (korrigjohen) në shqyrtimin e ardhshëm.

Konkretisht axhustimi përfshinë ndryshimin mes planifikimit dhe realizimit faktik të këtyre komponentëve: i) Të hyrave (të rregulluara dhe të parregulluara); Kostove Operative; Zhvlerësimin vjetorë; dhe kthimit në RAB_t.

Vlera totale e axhustimit për sezonin paraprak 2018/19 është llogaritur: **-554,219 €**. Pra vlera totale e axhustimit prej -554,219 € zbritet nga vlera e të Hyrave të lejuara për sezonin 2019/2020

3.7 Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara - Përmbledhje

Të hyrat e lejuara totale janë llogaritur sipas formulës:

$$\text{MAR} = \text{OC} + \text{DEP} + \text{RTN} + \text{LOS} +/\text{- ADJ}$$

Fillimisht duhet theksuar se në llogaritjen e të Hyrave maksimale të lejuara merren Kostot operative të zbritura për koston e lejuar të humbjeve (kostot operative të ashtuquajtura neto në vlerë prej 4,309,403 €)

Rrjedhimisht vlera e MAR është e barabartë me **6,472,902 €** siç paraqitet detalisht në tabelën 6.



Tabela 6: Të Hyrat e lejuara për NQ Termokos sezoni i ngrohjes 2019/2020

Të Hyrat e Lejuara NQ TERMOKOS për sezonin 2019/2020		Lejuar nga ZRRE [€]
OC	Kostot Operacionale të Lejuara	4,309,403
DEP	Zhvlerësimi Vjetor	1,652,974
RTN	Kthimi i Lejuar në RAB _f	843,283
LOS	Kostot e lejuara te humbjeve	221,461
ADJ	Axhustimi – ndryshimi mes lejimeve dhe realizimeve	-554,219
MAR	Të Hyrat Maksimale të Lejuara	6,472,902

Për të qenë në përputhshmëri me strukturën tarifore, që parasheh ndarjen në komponentën për kapacitetin termik (komponenti fiks) dhe në komponentën e sasisë së energjisë termike (komponenti variabil), ndarja e MAR-it bëhet sipas proporcionit: pjesa fikse 15% dhe pjesa variabile 85%. Rrjedhimisht ndarja e MAR-it në pjesën fikse dhe variabile për sezonin e ngrohjes 2019/2020 është si vijon:

Pjesa fikse e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR_f) **970,935 €; dhe**
Pjesa variabile e të Hyrave të Lejuara (MAR_v) **5,501,967 €.**

4 Bilanci i Energjisë Termike

Bilanci i energjisë termike është një komponentë mjaft e rëndësishme në shqyrtimin tarifor sepse përcaktohen projeksionet për prodhimin/blerjet e energjisë termike, humbjet në rrjet dhe përfundimisht furnizimin e konsumatorëve. Për këtë arsye projeksionet në Bilanc janë me ndikim në planifikimin e kostove respektive, dhe rrjedhimisht me ndikim në përcaktimin e të Hyrave të lejuara dhe tarifave.

Në vijim në forma tabelare dhe grafike janë paraqitur të përmbledhur komponentët e Bilancit të energjisë termike për NQ Termokos për sezonin 2019/2020.

Tabela 2: Përmbledhje e Bilancit të energjisë termike

Balanca e Energjisë Termike - NQ Termokos sez. 2019/2020		Propozuar nga NQ Termokos	Lejuar nga ZRRE
Bruto Prodhimi i En. Term.	MWh	6,820	6,820
Bruto Blerjet e En. Term. (Hyrja në Rrjet. Transp.)	MWh	251,248	251,248
Neto Blerjet e En. Term. (Dalja nga Rrjet. Transp.)	MWh	246,223	246,223
Humbjet sasiore në Rrjetin e Transportit	MWh	5,025	5,025
Humbjet në përqindje në Rrjetin e Transportit	%	2.00%	2.00%
Bruto Prodhimi + Bruto Blerjet e En. Term.	MWh	258,068	258,068
Humbjet sasiore në Rrjet. Transp. + Konsumi vetanak	MWh	5,845	5,845
Neto Prodhimi + Neto Blerjet e En. Term. (Hyrja në Rrjet. Shpërnd.)	MWh	252,223	252,223
Humbjet sasiore në Rrjetin e Shpërndarjes	MWh	17,050	17,050
Humbjet në përqindje në Rrjetin e Shpërndarjes	%	6.76%	6.76%
Furnizimi / Konsumi i En. Term.	MWh	235,172	235,172




Figura 3: Paraqitje grafike e Bilancit të energjisë termike për NQ Termokos –sezoni 2019/2020